



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

MISIONI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Misioni i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është gjykimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve penale dhe civile, në përputhje me normat juridike në fuqi dhe të bazuara në fakte të provuara, duke dhënë vendime të drejta, në frymën e Kushtetutës dhe Ligjeve.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, udhëhiqet nga parimet e Shtetit të së Drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, barazisë përpara ligjit, pavarësisë së organeve gjyqësore dhe transparencës.

Zbatimi rigoroz i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjeve dhe në tërësi korpusit juridik të detyrueshëm në Shqipëri, garanton misionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për të mbrojtur dinjitetin dhe liritë themelore të njeriut, në përputhje me kërkesat dhe në funksion të zhvillimit të një shoqërie demokratike që aspiron integrimin European.

Stafi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, synon të realizojë me cilësi dhe efektivitet ofrimin e shërbimeve gjyqësore për qytetarët brenda afateve dhe në përputhje me normat ligjore.

Menaxhimi efektiv dhe cilësor i fondeve buxhetore, me frymën e bashkëveprimit profesional dhe të përgjegjshëm të stafit të saj, pasqyron misionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve për marrjen e shërbimeve dhe aksesit në informacion për publikun e gjerë, në kohë dhe me cilësi.

OBJEKTIVAT KRYESORË TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të palëve në proceset gjyqësore.
- Sundimin e së drejtës dhe ligjit në gjykimin e mosmarrëveshjeve.
- Gjykimin e çështjeve brenda afateve të arsyeshme dhe të përcaktuara në ligj.

- Pasqyrimin e standarteve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Kritjën dhe forcimin e besimit të qytetarëve dhe opinionit publik në drejtësinë evendimevegjyqësore.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj publikut, duke aplikuar progresivisht arritjet teknologjike dhe burimet njerëzore, me kapacitete profesionale të larta.
- Krijimin e një mjedisi profesional, dinamik dhe ndërveprues ndërmjet anëtarëve të administratës gjyqësore, duke reflektuar integritet, përgjegjshmëri dhe kulturën e të punuarit në grup.

KOMPETENCAT TOKËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARËTË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shqyrton çështje që përfshihen në kompetencën territoriale të Qarkut të Elbasanit, në fushën e së drejtës civile dhe penale. Veprimtaria e Gjykatës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqetarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në ligje e akte të tjera juridike, në fuqi, që normojnë veprimtarinë e Gjykatës, Gjyqtarëve, administratës së Gjykatave, shërbimeve gjyqësore, menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe marrëdhënien e Gjykatësme degët e tjera të pushtetit shtetëror, publikun dhe median.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ushtron kompetencën e saj lëndore në territorin e Qarkut Elbasan, që mbulon përkatësisht bashkitë e mëposhtme: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh dhe Përrenjas. Vendndodhja e Gjykatës është në qytetin e Elbasanit me adresë : Lagjja ‘5 Maji’ , Rruga ‘Koço Brisku’, Elbasan, Shqipëri.

INFRASTRUKTURA E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Ndërtesa ku ndodhet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është ndërtuar në vitin 2017 dhe përmban 20 zyra gjyqtarësh, 10 zyra të punonjësve administrativë, 10 salla gjyqi (2 penale dhe 8 civile).

Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ndodhet në një ndërtesë bashkëngjitur asaj të Gjykatës, por të ndarë prej saj.

Gjykata i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit *ex-parte* (ndodhen hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e Gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Hapësira e shërbimit ndaj publikut është e krijuar sipas standardeve të kërkuara.

BURGJET/STRUKTURAT E TJERA NËN KOMPETENCËN TOKËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Aktualisht nën kompetencën tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë 3 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale:

- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, me një distancë tëpërlllogaritur prej 6 km nga ndërtesa e Gjykatës.
- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, me një distancë tëpërlllogaritur prej 30 km nga ndërtesa e Gjykatës.
- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lushnje me një distancë tëpërlllogaritur prej 46 km nga ndërtesa e Gjykatës.